# Planifikimi i një Sistemi Përgjegjshmërie në Shqipëri

Dr. Elaine Kamarck

Janar 2014

Përgatitur për Qeverinë Shqiptare

# Shumë vende kanë ngritur sisteme përgjegjshmërie:

- Ky sistem ka qënë pjesë e lëvizjes së reformës në qeveri që filloi në vendet Anglo-Amerikane në vitet '90.

# Qendra e Deparatamenteve Qeveritare të Jetësimit

- – janë organizata të projektuara për të asistuar kreun e qeverisë në monitorimin e progresit drejt qëllimeve të caktuara
- – në këtë kuptim, ato ndryshojnë nga operacionet në vazhdim që mund të jenë pjesë e Ministrisë së Financave ose Zyrës së Buxhetit
- – shpesh ato caktohen për të monitoruar axhendën e një reforme

# Tri Axhenda Shqiptare për Reformë

- Synimet e planit 300-ditor të Kryeministrit
- Synimet për anëtarësimin në BE
- Synimet e nxitura nga Donatorët

# Hapi #1

- Kombinimi i axhendave të ndryshme në një grup objektivash
- Duke patur parasysh rëndësinë e anëtarësimit në BE, si edhe nivelet e larta të interesit të donatorëve dhe axhendën ambicioze të Qeverisë, bashkimi i këtyre grupeve në një plan koherent është i një rëndësie tejet të madhe.

# Hapi #2

- Zhvillimi i njësive matëse të rezultatit, outputit dhe inputit për gjithë objektivat e mëdha
- Kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me grupet e interesit brenda dhe jashtë qeverisë
- Në departamentin e jetësimit të prioriteteve duhet të ketë një person përgjegjës që të sfidojë këto objektiva, sepse shpesh liderat në qeverisje do mundohen të caktojnë objektiva modestë të cilët janë të sigurtë që do i arrijnë.

# Hapi #3

- Departamenti i Jetësimit duhet të ketë staf i cili të kuptojë:
  - Ku ndodhet Qeveria Shqiptare dhe ku duhet të shkojë;
  - Politikat që kanë rrethuar zgjedhjet e fundit dhe koalicionin e maxhorancës parlamentare ;
  - Si të përdorë statistikat në caktimin e masave për performancën qeveritare.

# Hapi #4

- Angazhimi i Kryeministrit dhe zyrtarëve të tjerë të lartë në jetësimin e objektivave më të mëdha.
- Caktimi i një rutine në të cilën Kryeministri telefonon, dërgon emaile ose takohet me zyrtarë të agjencive të paktën një herë në muaj – thjesht për të diskutuar ecurinë e punës.
- Listoni, gjithashtu, zyrtarë të tjerë të lartë të qeverisë.

# Hapi #5

- Përcaktimi i një programi çmimi për zyrtarët e qeverisë
- Dhënia e çmimeve për personat që kanë dhënë kontribut të madh në drejtim të qëllimeve të përcaktuara në Planin qeveritar
- Reklamimi i fituesve të çmimeve në mënyrë që sjellja e tyre të shërbejë si model për zyrtarë të tjerë të qeverisë.

# Hapi #6

- Caktimi i një tabele të rregullt raportimi, si p. sh. raporti i 100 ditëve që u mbajt në dhjetor.
- Sigurohuni që raportet të kenë një komponent të publikut si dhe një komponent të brendshëm të qeverisë.
- Kjo është shumë e rëndësishme për të ndërtuar një qeveri që ka në qendër qytetarët.

# Hapi #7

- Rishikimi i rregullt i objektivave dhe masave, ndoshta çdo 12 muaj, për tu siguruar që janë akoma të rëndësishëm duke patur parasysh që situatat mund të ndryshojnë rëndësinë relative të disa qëllimeve në krahasim me qëllime të tjera.

# Nga se varet suksesi?

- Lidership nga kreu i qeverisë.
  - Kreu i qeverisë ose dikush pranë tij (Zv. Kryeministri, Drejtori i Kabinetit) duhet ti kërkojnë vazhdimisht Ministrave dhe drejtuesve të agjencive se si po ecin në përmbushjen e objektivave të tyre.
  - Ndërhyrje të vogla – me telefon ose email, një herë në muaj – mund të kenë ndikim të madh sepse në gjithë qeverinë do përhapet fjala që Kryeministri i ka marrë qëllimet

# Nga se varet suksesi?

Kërkesa për reformë nga qytetarët.

- Në vendet e zhvilluara qytetarët janë shumë kritikë ndaj qeverive. (Kryetarë bashkish të qyteteve të mëdha amerikane humbasin punën nëse dëbora nuk hiqet menjëherë mbas stuhisë.)
- Liderët politikë mund të zgjedhin që të përdorin fuqinë e tyre për të rritur presionin qytetar mbi qeverinë – krahun "kërkues" të reformës. Kjo është e rëndësishme në vendet me një histori regjimi totalitar. Në këto vende krahu "kërkues" i reformës ka tendencë të

# Nga se varet suksesi?

- Premtimet bëhen publike.
- Duke i bërë premtimet publike (sidomos premtimet e rezultateve), lidershipi i qeverisë dhe gjithë njësitë përkatëse angazhohen në zbatimin e tyre dhe publiku mund t’i konsiderojë ata përgjegjës.

# Nga se varet suksesi?

- Ekzistenca e një shoqërie civile ose "sektori të tretë" përbërë nga OJQ vendore (jo ndërkombëtare) që përbëhen nga qytetarë të cilët e ndjejnë se janë të rëndësishëm në politikën qeverisëse.

# Nga se varet suksesi?

- Të dhënat e besueshme e lejojnë qeverinë që të masë progresin.
  - Në vendet ku mosbesimi ndaj qeverisë është i lartë për shkak të një historie keqqeverisësje, të dhënat duhet të verifikohen nga burime të jashtme.
  - Ka mënyra të shumta me të cilat mund të sillen burime të jashtme që të verifikojnë të dhënat e qeverisë.

# Nga se varet suksesi?

- Krijimi i matricave të drejtuara nga rezultatet – p.sh. shprehen në mënyrë të kuptueshme nga njerëzit dhe kanë kuptim për jetën e tyre.
- Pastaj bëhet operacionalizimi i qëllimeve të rezultateve.
- Shiko diapozitivën pasuese…

# 3 grupe matricash për menaxhim performance efektiv



# REZULTATE:

- Këto janë gjëra që qytetarët duan dhe mund të kuptojnë. Ato nuk janë e njëjta gjë me inputet dhe outputet.
- Për shembull: qytetarët duan rrugë të sigurta. Gratë duan që të mund të kthehen në shtëpi në mbrëmje të pashoqëruara dhe pa pasur frikë. Të paguash më shumë policë nuk do të thotë të arrish këtë qëllim, nëse këta policë punojnë vetëm gjatë ditës.

# OUTPUTE:

- Outputet janë masa të ndërmjetme gjërash që qeveria po përmbush.
- Për shembull:  Për të luftuar krimin një qeveri mund të punësojë 200 oficerë policie më shumë. Sidoqoftë, vetëm duke punësuar më shumë oficerë police nuk  do prodhohet “rezultati” i rrugëve më të sigurta nëse, për shembull, këta oficerë policie më shumë punojnë vetëm nga ora 9:00 deri në orën 17:00.

# INPUTE:

- Inputet janë gjëra që qeveria blen dhe për të cilat paguan:  tavolina, rroga, makina policie, armë, barna, etj.
- Inputet NUK garantojnë faktin që publiku ka marrë shërbimin e duhur.
- SHEMBULL:  Një qeveri mund të blejë vaksina të mjaftueshme poliomeliti për të vaksinuar çdo fëmijë në vend.  Por, nëse vaksinat vidhen dhe shiten në tregun e zi ose shpërndahen në mënyrë që është e vështirë për fëmijët që t'i marrin ato – objektivi i të mirës publike nuk arrihet. Nëse gjëra të tilla ndodhin, "inputi" nuk do ju çojë në "rezultatin" e fëmijëve të shëndetshëm dhe pa polio.

# Nga se varet dështimi?

- Kryeministri nuk u kushton vëmendje objektivave të caktuar. Në këtë rast ato shndërrohen në një tjetër ushtrim burokratik, jo shumë të rëndësishëm.
- Qytetarët janë bërë shumë cinikë për shkak të dështimeve të qeverisë së mëparshme, dhe ata nuk besojnë se qëllimet do arrihen ose besojnë që gjithë deklaratat e qeverisë janë

# Nga se varet dështimi?

- Të dhëna jo të plota ose të pasakta ose të dhëna që nuk përputhen me atë që qytetarët përjetojnë çdo ditë.
- Kapaciteti i ulët institucional dhe nivelet e larta të korrupsionit në një vend, bëjnë që marrja e informacionit të performancës të jetë në nivele të ulta.

# Nga se varet dështimi?

- Imponimi i qëllimeve dhe objektivave  nga jashtë vendit (shpesh donatorë) pa asnjë bashkëpunim të brendshëm për të krijuar ose rënë dakort mbi qëllimet.

# Nga se varet dështimi?

- Media (gazetat, televizioni, interneti) që kontrollohet dhe monitorohet nga partitë politike dhe që nuk lejon raportim të ndershëm.

# Strategji për të evituar dështimin...

- Sigurohuni që gjithkush që kryeson një pjesë të qeverisë, e kupton që qëllimet janë për të:
  - Shënuar progresin
  - Identifikuar problemet
  - Ndihmuar në zgjidhjen e problemeve

  Nëse objektivat dhe qëllimet bëhen shumë ndëshkues, kjo gjë do të inkurajojë mashtrimin nga ana e punonjësve të shërbimit civil. (Mund të sjell shumë shembuj nga e gjithë bota.)

# Strategji për të evituar dështimin...

- Shndërrojeni departamentin e jetësimit në një vend ku mësimet mësohen dhe përdoren për të përmirësuar performancën.
- Sistemi i menaxhimit të performancës më i famshëm në botë – programi COMPSTAT i qytetit të New York-ut – është një operacion i mësimit të praktikave më të mira.

# Strategji për të evituar dështimin…

- Ndëshkimi i zyrtarëve qeveritarë që gënjejnë në lidhje me statistikat zyrtare ose i manipulojnë ato.
- Sigurohuni që qeveria ta dijë se Kryeministri e konsideron këtë një formë korrupsioni.